



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 189

Tiranë – E Hënë, 15 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 95/2014 datë 27.11.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 10453
Vendim i Kuvendit nr. 96/2014 datë 27.11.2014	Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë..... 10453
Vendim i Kuvendit nr. 97/2014 datë 27.11.2014	Për procedurën paraprake për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë..... 10454
Vendim i Kuvendit nr. 98/2014 datë 27.11.2014	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil..... 10455
Vendim i Kuvendit nr. 99/2014 datë 27.11.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 10458
Vendim i Kuvendit nr. 100/2014 datë 27.11.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 10458
Vendim i Kuvendit nr. 101/2014 datë 27.11.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 10458
Vendim i Kuvendit nr. 102/2014 datë 27.11.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 10458
Vendim i Kuvendit nr. 103/2014 datë 27.11.2014	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 10459

Vendim i Kuvendit nr. 104/2014 datë 27.11.2014	Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.....	10459
Dekret i Presidentit nr. 8828, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10459
Dekret i Presidentit nr. 8829, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10459
Dekret i Presidentit nr. 8830, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10460
Dekret i Presidentit nr. 8831, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10460
Dekret i Presidentit nr. 8832, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10460
Dekret i Presidentit nr. 8833, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10460
Dekret i Presidentit nr. 8834, datë 3.12.2014	Për emërim prokurori.....	10461
Udhëzim i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 7, datë 1.10.2014	Për kërkesat që duhet të përmbushë administratori/shoqëria e administrimit për t'u listuar në librin e administratorëve, procedurat e listimit, heqjes nga lista, penaltetet, procedura për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre.....	10461
Udhëzim i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministrisë së Financave nr. 4441/2, datë 19.11.2014	Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet, që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar.....	10469
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 18.11.2014	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015.....	10473
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 18.11.2014	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015.....	10474
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 19.11.2014	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për OST sh.a.....	10474
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 19.11.2014	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për KESH sh.a.....	10475
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 19.11.2014	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për OSHEE sh.a.....	10475

Vendim i Entit Rregullator të Ujit nr. 20, datë 20.10.2014	Për rinovim licence sh.a Ujësjellës Orikum.....	10476
Vendim i Entit Rregullator të Ujit nr. 21, datë 14.11.2014	Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Kurbin.....	10476
Vendim i Entit Rregullator të Ujit nr. 22, datë 14.11.2014	Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015.....	10477
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 159, datë 1.12.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në qarkun Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	10477
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7302, datë 1.12.201	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (objekte, lotet 6,7,8,11)”.....	10478
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7364, datë 3.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe e Tiranës, (objekte)”.....	10480
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 7402, datë 4.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bashkia Kamëz-Ura Tapizë”.....	10481
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7536/1, datë 12.12.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rehabilitimi i zonave pranë rrethrrrotullimeve dhe kryqëzimeve, segmenti Rrogozhinë-Fier”.....	10485
	Vendim (i shkurtur) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Irfan Beqirllari.....	10488

**VENDIM
Nr. 95/2014****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166,
DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh nga pozita parlamentare, si dhe të një grupi deputetësh nga opozita parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në Rregulloren e Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 20, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Deputeti është anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.”.

Neni 2

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli ndryshohet si më poshtë:

“E drejta e fjalës për anëtarët e Këshillit të Ministrave”.

b) Pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/2. Kur e merr fjalën Kryeministri, ka të drejtë të bëjë komente menjëherë pas tij edhe kryetari i grupit parlamentar më të madh të opozitës, ose një përfaqësues i caktuar prej tij, për të njëjtën kohë sa ajo e Kryeministrit.”.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 27.11.2014

**VENDIM
Nr. 96/2014****PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN NË SISTEMIN E
DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- Analizimin e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, dhe diskutim gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjektet e tjera të interesuara dhe opinionin publik.

- Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë.

- Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik.

III. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 janë përfaqësues të shumicës parlamentare (5 PS, 1 LSI) dhe 5 përfaqësues të pakicës parlamentare (3 PD, 1 PR dhe 1 PDIU). Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Kryetari i komisionit është përfaqësues i shumicës parlamentare dhe zëvendëskryetari është përfaqësues i pakicës parlamentare.



V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6-mujor. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të komisionit, Kuvendi mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VI. Komisioni i Posaçëm organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare.

VII. Pranë Komisionit të Posaçëm ngrihet dhe funksionon grupi i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë.

Në cilësinë e ekspertëve ndërkombëtarë, komisioni do të ftojë të marrin pjesë përfaqësues të Komisionit European (Misioni Euralius), të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID/OPDAT), të Këshillit të Europës (Komisioni i Venecias), të Prezencës së OSBE-së dhe të misioneve të asistencës për çështjet e drejtësisë të përfaqësive diplomatike në Tiranë etj.

Numri dhe përbërja e grupit të ekspertëve përcaktohen me vendim të komisionit. Komisioni mund të ftojë për konsultime për çështje specifike edhe ekspertë të tjerë ndërkombëtarë të mirënjohur në fushat përkatëse.

VIII. Pranë Komisionit të Posaçëm, në mbështetje edhe të grupit të ekspertëve vendas e ndërkombëtarë, ngrihet dhe funksionon sekretariati teknik, i përbërë nga këshilltarë/specialistë të Shërbimit Juridik të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, juristë të institucioneve të tjera shtetërore, si dhe juristë të tjerë me përvojë që do të ftohen të kontribuojnë si pjesë e kësaj strukture.

IX. Komisioni i Posaçëm në veprimtarinë e tij:

- Do të zhvillojë konsultime, seanca dëgjimore dhe diskutime me:

i) Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë;

ii) organet përfaqësuese të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë;

iii) ekspertë të fushës;

iv) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që mbulojnë çështjet e drejtësisë;

v) përfaqësues të shoqërisë civile.

- Do të mbledhë informacione nga opinioni publik nëpërmjet një portali online, të krijuar posaçërisht për këtë qëllim.

- Do të organizojë debate publike në media etj.

X. Për çdo element të objektit të veprimtarisë së tij, Komisioni i Posaçëm do të organizojë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe nën kujdesin e Presidentit të Republikës, tryeza pune gjithëpërfshirëse me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë dhe subjektet e tjera të interesuara.

XI. Çdo parti tjetër joparlamentare, që nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime pranë komisionit.

XII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për krijimin e kushteve të punës, mbështetjen financiare e logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm, grupit të ekspertëve dhe sekretarisë teknike.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir Meta

Miraturar më datën 27.11.2014

VENDIM

Nr. 97/2014

PËR PROCEDURËN PARAPRAKE PËR PËRZGJEDHJEN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, nenit 111, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 54, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e procedurës paraprake për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, sipas fazave të mëposhtme:

a) Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën e pozicionit të Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik). Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit/ kandidatëve për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit /kandidatëve me shkrim. Afati i dorëzimit të



dokumentacionit të bëhet brenda 10 ditëve nga publikimi.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara, u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjuesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare, për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë, përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t'ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake e propozuar në pikën I, të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

VENDIM
Nr. 98/2014

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe në nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, me propozimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

II. Struktura e KMSHC-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Organika e KMSHC-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.


IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

STRUKTURA E KOMISIONERIT PËR MBIQYRJEN E SHËRBIMIT
CIVIL

SKEMA 1



SKEMA 2**ORGANIKA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS	NUMRI
I. KOMISIONERI		<u>1</u>
KABINETI		<u>(2)</u>
KËSHILLTAR		1
SEKRETAR		1
II. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES		<u>(15)</u>
DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a	1
II/1. DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE HETIMIT ADMINISTRATIV		<u>(7)</u>
DREJTOR	II-b	1
INSPEKTOR	III-b	6
II/2. DREJTORIA E MBIKËQYRJES		<u>(7)</u>
DREJTOR	II-b	1
INSPEKTOR	III-b	6
III. DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË		<u>(5)</u>
DREJTOR	II-b	1
SPECIALIST	III-b	4
IV. DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		<u>(8)</u>
DREJTOR	II-b	1
SPECIALIST (IT)	IV-a	1
SPECIALIST (MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN & BURIMET NJERËZORE)	IV-a	1
SPECIALIST (FINANCË/BUXHET)	III-b	1
SPECIALIST (ARKIV/PROTOKOLL)	IV-b	1
PUNONJËS MIRËMBAJTJEJE		1
SHOFER		1
PASTRUES		1
PUNONJËS GJITHSEJ		<u>31</u>

**VENDIM**
Nr. 99/2014**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI**
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Xhemal Mato zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

VENDIM
Nr. 100/2014**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI**
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Valbona Sulçe zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

VENDIM
Nr. 101/2014**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI**
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Helidon Haliti zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

VENDIM
Nr. 102/2014**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI**
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Xhelil Aliu zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014



VENDIM
Nr. 103/2014

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Vladimir Grosha zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

VENDIM
Nr. 104/2014

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË
SISTEMIN E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet përbërja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë si më poshtë:

1. Fatmir Xhafaj	PS	kryetar
2. _____	PD	zëvendëskryetar
3. Armando Subashi	PS	sekretar
4. Pandeli Majko	PS	anëtar
5. Vasilika Hysi	PS	anëtare

6. Ulsi Manja	PS	anëtar
7. Spartak Braho	LSI	anëtar
8. _____	PD	anëtar
9. _____	PD	anëtar
10. _____	PR	anëtar
11. _____	PDIU	anëtar
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.		

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.12.2014

DEKRET
Nr. 8828, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje që nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Andi Pogaçe, prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Fier, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8829, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Aida Cakaj, prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Fier, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8830, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Englantina Shehu, prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Fier, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8831, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Armanda Xhaferri, prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Elbasan, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8832, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Olgert Rumnici, prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Berat, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8833, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Saimir Smaka, prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Vlorë, të emërohet në këtë Prokurori.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8834, datë 3.12.2014

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ylli Pjetërnikaj, prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Kukës, të emërohet në prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Lezhë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 7, datë 1.10.2014

**PËR KËRKESAT QË DUHET TË
PËRMBUSHË ADMINISTRATORI/
SHOQËRIA E ADMINISTRIMIT PËR T’U
LISTUAR NË LIBRIN E ADMINISTRA-
TORËVE , PROCEDURAT E LISTIMIT,
HEQJES NGA LISTA, PENALITETET,
PROCEDURA PËR DHËNIEN E LEJES
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, SI
DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË
SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 19, pika 2, nenit 22, pika 1 dhe nenit 46, pika 2, të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

UDHËZON:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë kërkesat, që duhet të përmbushë administratori/shoqëria administruese, për t’u listuar në Librin e Administratorëve, procedurat e listimit, heqjes nga lista, penalitetet, procedurat për dhënie e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e administrimit të bashkëpronësisë, në ndërtesat e banimit, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.

2. Termat në vijim i referohen termave të njëjtë, të përdorur në nenin 2 të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

3. “Administrator” është personi fizik i përfshirë në librin e administratorëve, të mbajtur nga njësia vendore përkatëse, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit, në ndërtesat e banimit.

4. “Shoqëria administruese” është personi juridik, privat, i përfshirë në librin përkatës të mbajtur nga njësia vendore përkatëse, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit në ndërtesat e banimit.

5. “Libri i Administratorëve” është libri, që mbahet pranë njësisë vendore përkatëse, nën juridiksionin e së cilës do të ushtrojnë



veprimtarinë për administrimin e ndërtesave administratori/shoqëria administruese.

6. “Kontratë për administrimin e bashkëpronësisë” është marrëveshja e shkruar që kryesia lidh në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve me administratorin/shoqërinë administruese.

7. “Lista e administratorëve” është tërësia e administratorëve dhe shoqërive administruese, të cilët janë të regjistruar në librin e administratorëve, listë e cila publikohet dhe shpallet në vendin e njohfimeve, si dhe në faqen zyrtare të njësies vendore përkatëse.

8. “Strukturë përkatëse” do të quhet çdo organizim administrativ, ekzistues ose i ri, që krijohet me vendim të kryetarit të njësies vendore përkatëse, për të kryer procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit, për regjistrimin apo heqjen nga libri i administratorëve të subjekteve, si dhe propozimin për marrjen e masave disiplinore, siç parashikohet në këtë udhëzim.

9. “Leje për ushtrimin e veprimtarisë” është dokumenti i vetëm zyrtar, që i jep të drejtën disponuesit, për të ushtuar (në kuptim të kësaj rregulloreje) veprimtarinë e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesa banimi, në zbatim të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” dhe dispozitave të tjera nënligjore në zbatim të tij. Më poshtë do të quhet “Leje”.

10. “Komision” është struktura e posaçme administrative, përgjegjëse, që funksionon pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin në ndërtesat e banimit, ndryshimin, revokimin dhe vendosjen e penalteteve, sipas këtij udhëzimi.

11. “Sekretaria e komisionit” është struktura përkatëse pranë drejtorisë përgjegjëse në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që kryen procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit dhe regjistrimit të subjekteve, që ushtrojnë veprimtarinë e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

KREU II

KËRKESAT PËR REGJISTRIM

1. Personi fizik, i cili kërkon të regjistrohet në librin përkatës të administratorëve duhet të plotësojë këto kushte:

1.1 Të ketë përfunduar, të paktën, shkollën e mesme të përgjithshme, apo profesionale (niveli 2+1+1).

1.2 Të ketë përfunduar një kurs formimi profesional për administrimin e banesave në bashkëpronësi, në një nga institucionet publike të formimit profesional, në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, apo private, të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimeve.

1.3 Të mos jetë dënues për vepra penale të kryera, të konfirmuar nga organet shtetërore, jo më parë se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

1.4 Të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), si person fizik.

1.5 Të jetë i pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave në bashkëpronësi, të marrë në ministrinë, që mbulon çështjet e bashkëpronësisë në banesa, sipas kreut III.

2. Personi fizik, për t’u regjistruar në librin përkatës të administratorëve, duhet të paraqesë dokumentet origjinale, ose kopje të noterizuara, si më poshtë:

2.1 Kërkesë me të dhënat e përgjithshme, e plotësuar dhe nënshkruar prej tij, të shoqëruar me dy fotografi.

2.2 Kopje të dokumenteve, që vërteton plotësimin e kushteve, sipas pikës 1 të këtij kreu.

3. Personi juridik, i cili kërkon të ushtrojë veprimtari për administrimin e ndërtesave, duhet të plotësojë këto kushte:

3.1 Të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), si person juridik me objekt veprimtarie, ndër të tjera, veprimtarinë e administrimit të ndërtesave në bashkëpronësi, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

3.2 Të ketë të punësuar, të paktën, një person, i cili duhet të plotësojë kriteret sipas pikës 1, kreu II, të këtij udhëzimi.

3.3 Administratori i shoqërisë të mos jetë dënues për vepra penale të kryera, të konfirmuar nga organet shtetërore, jo më parë se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

3.4 Të jetë i pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave në bashkëpronësi, të marrë në ministrinë, që



mbulon çështjet e bashkëpronësisë në banesa, sipas kreut III.

4. Personi juridik, për t'u regjistruar në librin e administratorëve, duhet të paraqesë dokumentet origjinale, ose kopje të noterizuara, si më poshtë:

4.1 Kërkesë me të dhënat e përgjithshme, i plotësuar dhe nënshkruar rregullisht prej përfaqësuesit ligjor të subjektit kërkuar, të shoqëruar me dy fotografi të tij.

4.2 Kopje të dokumenteve, që vërteton plotësimin e kushteve, sipas pikës 3 të këtij kreu.

5. Subjektet, të cilat kanë kryer të paktën arsimin e mesëm dhe që aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e administratorit, duhet të pajisen me certifikatën e kryerjes së kursit të formimit profesional, sipas kreut II, pika 1.2, brenda një periudhe 2-vjeçare nga data e miratimit të këtij udhëzimi.

6. Kurrikulat për mësimdhënien në kurset e administrimit të banesave në bashkëpronësi, hartohen dhe miratohen nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

KREU III

PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LEJES PERSONAVE FIZIKË DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, NË FUSHËN E ADMINISTRIMIT TË BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESAT E BANIMIT

1. Komisioni i posaçëm i dhënies së lejes për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave

1.1 Leja për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave (leja) për subjektet, që merren me administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa banimi, jepet nga komisioni i krijuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

1.2 Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë dhe miratohet me urdhër të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

1.3 Komisioni kryesohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga nënkryetari. Si rregull, komisioni mbledhet një herë në muaj, në varësi të kërkesave dhe problematikës së paraqitur. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës, shoqëruar me materialet respektive, i vihen në dispozicion komisionit, nga sekretaria e komisionit, të paktën

3 ditë kalendarike, përpara ditës së mbledhjes. Në rastet kur shihet e arsyeshme, kryetari mund të mbledhë komisionin jashtë radhës.

1.4 Komisioni merr vendime, që kanë të bëjnë me dhënien e lejes subjekteve, që plotësojnë kërkesat për marrjen e saj, konform kësaj rregulloreje. Vendimet merren në mbledhjen e komisionit me votim. Në rastin e një votimi të barabartë, vota e kryetarit të komisionit është përcaktuese.

1.5 Në mbledhje mbahet protokoll nga sekretaria e komisionit. Protokollin përmban të dhëna për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve. Procesverbali i mbledhjes dhe vendimi i komisionit, hartohen, mbështetur në protokoll dhe mbi çka është vendosur në mbledhjen respektive dhe nënshkruhet e miratohet.

1.6 Komisioni, në mbledhjen e tij, shqyrton dhe materialet e ndryshme të ardhura zyrtarisht në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, nga subjektet publike e jopublike, për probleme të vërejtura në procesin e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesa banimi dhe masa konkrete, të propozuara nga ato.

1.7 Komisioni, pas shqyrtimit të problemeve të bëra prezent, merr vendime dhe bën propozime për masa konkrete ndaj shkeljeve të konstatuara dhe sipas rastit, ia dërgon strukturave të kontrollit dhe inspektimit të Ministrisë, për të bërë verifikime për problematikat e paraqitura.

1.8 Komisioni për çështje, që do të shqyrtohen, sipas objektit dhe materialit, të cilat kanë nevojë për informacion të mëtejshëm apo verifikim, fton në mbledhje dhe përfaqësues të njëjësive vendore dhe strukturave të tjera përkatëse, të përcaktuar në ligjin nr. 10112, datë 9.4.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit".

1.9 Informacioni i kërkuar nga komisioni përgatitet me shkrim, i cili nëpërmjet sekretarisë së komisionit, i paraqitet komisionit në mbledhjen e radhës, për të marrë vendimet përkatëse.

2. Organizimi dhe funksionimi i sekretarisë teknike të komisionit

2.1 Funksionin e sekretarisë teknike të komisionit të dhënies së lejes, e kryen struktura përkatëse pranë Drejtorisë përgjegjëse për dhënien e lejeve në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.



2.2 Kërkesat dhe dokumentacioni i nevojshëm i aplikuesve për marrjen e lejes në këtë fushë, dërgohen në rrugë postare pranë sekretarisë së komisionit, nëpërmjet sektorit të arkivit dhe protokollit pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2.3 Sekretaria, verifikon rregullshmërinë ligjore të dokumentacionit të paraqitur, sipas kushteve dhe kriterëve të kësaj rregullore dhe përgatit materialin për mbledhjen e komisionit.

2.4 Në mbledhjen e radhës së komisionit, nga sekretaria, paraqiten, për shqyrtim, dokumentet e pranuar (protokolluara) të paktën deri 5 ditë para datës së mbledhjes. Njoftimet për vendimmarrjet e komisionit dhe dhënien e dokumentit të lejes, subjekteve dhe palëve të interesuara, e kryen sekretaria e komisionit.

2.5 Vendimet e marra nga komisioni dokumentohen në procesverbalin e mbledhjes nga sekretaria. Më pas, ajo përgatit vendimin përkatës, që firmoset së bashku me procesverbalin nga të gjithë anëtarët e komisionit, prezent në ditën e mbledhjes.

2.6 Mbi bazën e vendimeve të miratuara të komisionit, sekretaria përgatit lejet në 3 (tri) formate origjinale, që firmoset nga kryetari i komisionit dhe e kundërfirmuar nga sekretaria e komisionit. Dy nga lejet mbahen në arkivin e sekretarisë së komisionit dhe Ministrisë dhe e treta i dorëzohet subjektit apo përfaqësuesit të autorizuar të tij. Dorëzimi mund të bëhet dhe me anë të postës, në adresën e deklaruar prej subjektit përfitues.

2.7 Lista e subjekteve me leje, regjistrohet në regjistrin themeltar të subjekteve me leje, publikohet dhe përditësohet nga sekretaria në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si dhe i vihet në dispozicion çdo subjekti publik, që e kërkon.

2.8 Sekretaria e komisionit ka të drejtë që të shqyrtojë dhe të vendosë, pa pasur nevojë për të kaluar në komision, për kërkesat e subjekteve në lidhje me reflektimin në leje të ndryshimeve:

a) Të emërimit të subjektit dhe selisë së tij.

b) Përfaqësuesit ligjor, në vijim të ndryshimeve të kryera në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

c) Çregjistrimin e subjektit apo individit nga lista e subjekteve, që disponojnë leje.

Për këto ndryshime hartohet procesverbal i

veçantë, i cili i paraqitet kryetarit të komisionit për justifikimin e ndryshimit, dokument ky, që qëndron në dosjen e aplikimit.

3. Leja për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave (leja)

3.1 Leja është një akt administrativ, i cili e lejon disponuesin e saj të ushtrojë veprimtari në administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa banimi. Komisioni jep:

a) leje për persona fizikë;

b) leje për subjektet juridike.

3.2 Elementet e lejes janë:

a) Emërtimi dhe stema e institucionit që lëshon lejen;

b) Numrin e lejes (i cili përfiton fraksion, për çdo ndryshim që miratohet në vijim);

c) Të dhënat për identifikimin e subjektit, që do të disponojë lejen;

d) Fushën e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë;

e) Emrin e kryetarit të komisionit, nënshkrimin e tij dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) Aneksin, që përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj;

g) Fotografinë e personit fizik që merr lejen;

h) Në rastin e subjekteve juridike, të dhëna për përfaqësuesit ligjor, administratorin/administratorët e punësuar dhe afatin e vlefshmërisë.

Formati i lejes miratohet me urdhër të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3.3 Leja për personat juridik jepet në përputhje me pikën 4 të këtij udhëzimi. Leja nuk lejohet të shitet, tjetërsohet apo të trashëgohet nga një individ apo subjekt tek një tjetër. Pajisja e subjekteve, me leje bëhet brenda 30 ditëve, nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë, të përcaktuar në këtë rregullore.

4. Kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për t'u pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave.

4.1 Personi fizik përfiton të drejtën të ushtrojë veprimtari në administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa banimi, kur plotëson kushtet, sipas kreut II, pika 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4.2 Aplikimi për t'u pajisur me leje për personat fizikë, kryhet duke paraqitur dokumentacionin origjinal ose kopje të njehsuara



me noter (të gjithë dokumentet në gjuhën shqipe) pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë:

- Dokumentin e regjistrimit pranë QKR.
- Dokumentin që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesionale (niveli 2+1+1).
- Dokumentin e përfundimit të kursit të formimit profesional për menaxhimin e banesave në bashkëpronësi, sipas kreut II, pika 1.2.
- Vetëdeklarimin (sipas formularit të lidhjes 1, bashkëlidhur) ku deklarohet se nuk është në proces gjyqësor dhe në ndjekje penale, në lidhje me profesionin ku kërkon të marrë lejen.

Gjithashtu:

- Kërkesë me shkrim për pajisje me leje, (që duhet të përmbajë të paktën emrin, atësinë, mbiemrin, adresën e plotë dhe pikën e kontaktit).
- Dy foto për dokument.

4.3 Leja për subjektet, sipas kreut II, pika 5, të këtij udhëzimi, lëshohet me afat deri në 2 vjet nga miratimi i këtij udhëzimi, pasi subjektet të kenë plotësuar dokumentacionin si vijon:

- Dokumentin e regjistrimit pranë QKR.
- Dokumentin, që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesionale (niveli 2+1+1).
- Vetëdeklarimin (sipas formularit të lidhjes 1, bashkëlidhur udhëzimit) ku deklarohet, se nuk është në proces gjyqësor dhe në ndjekje penale, në lidhje me profesionin ku kërkon të marrë lejen.

Gjithashtu:

- Kërkesë me shkrim për pajisje me leje.
- Dy foto për dokument.

4.4 Personi juridik, përfiton të drejtën të ushtrojë veprimtari në administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa banimi, kur plotëson kushtet, sipas kreut II, pika 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

4.5 Aplikimi për t'u pajisur me leje për subjektet juridike, kryhet duke paraqitur dokumentacionin origjinal ose kopje të njehsuara me noter (të gjithë dokumentet në gjuhën shqipe) pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë:

- Dokumentin e regjistrimit pranë QKR.
- Dokumentin, që vërteton se personi

përgjegjës për administrimin e bashkëpronësisë së subjektit juridik disponon paraprakisht leje individuale për këtë fushë, të përfituar më parë. Ose në rast se nuk disponon leje, dokumentet e përcaktuara në pikën 4.3 të këtij kreu.

- Vetëdeklarimin e përfaqësuesit ligjor dhe personit përgjegjës për administrimin (sipas formularit të lidhjes 2 bashkëlidhur), ku deklarohet se nuk është në proces gjyqësor dhe në ndjekje penale në lidhje me profesionin ku kërkon të marrë leje.

Gjithashtu:

- Kërkesën e subjektit juridik, që aplikon për leje (që duhet të përmbajë të paktën emrin, atësinë, mbiemrin, adresën e plotë dhe pikën e kontaktit).

4.6 Rinovimi apo dublikatë (në rastet e humbjes apo dëmtimi) e lejes së subjektit juridik, kryhet në rast se ai plotëson kushtet si më poshtë:

a) Të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), si subjekt juridik me veprimtari në fushën e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesa banimi dhe të ketë status aktiv.

b) Të mos jetë në ndjekje penale, apo proces gjyqësor për veprime të kryera në këtë veprimtari.

c) Të mos jetë brenda periudhës së një penalizimi të mëparshëm nga "Struktura përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore apo komisioni i lejeve, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për parregullsi.

4.7 Aplikimi për rinovimin apo dublikimin e lejes për subjektet juridike, sipas pikës 4.6 të këtij kreu, kryhet duke paraqitur dokumentacionin origjinal, ose kopje të njehsuara me noter (të gjithë dokumentet në gjuhën shqipe) pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë:

- Dokumentin e regjistrimit pranë QKR, me statusin aktiv.

- Vetëdeklarimin e përfaqësuesit ligjor dhe personit përgjegjës për administrimin (sipas formularit të lidhjes 2 bashkëlidhur), ku deklarohet se nuk është në proces gjyqësor dhe në ndjekje penale, në lidhje me profesionin, ku kërkon të marrë leje.

- Vërtetimin e njësisë vendore respektive, në lidhje me pasjen ose jo të penaliteteve.



Gjithashtu:

- Kërkesën e subjektit juridik, që aplikon për leje (që duhet të përmbajë të paktën emrin, atësinë, mbiemrin, adresën e plotë dhe pikën e kontaktit).

- Për rastet kur administratori është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i subjektit juridik, kontrata e punësimit, midis tyre, me afat jo më të vogël se një vit.

4.8 Për rastet kur ka ndryshime në të dhënat e formularëve të lejes të tilla si ndryshim të emërimit të subjektit, selisë së subjektit, ndryshim të përfaqësuesit ligjor, ndryshim të administratorit apo mbyllje të aktivitetit të subjektit, kërkuuesi duhet të paraqesë dokumentet respektive, që vërtetojnë këto ndryshime dhe konkretisht:

- Kërkesën e subjektit juridik, që aplikon për ndryshime në leje.

- Dokumentin e regjistrimit pranë QKR, me statusin aktiv, që vërteton ndryshimin përkatës (ndryshim të emërimit të subjektit, selisë së subjektit; ndryshim të përfaqësuesit ligjor; apo mbyllje të aktivitetit të subjektit).

- Për rastet kur kërkohet ndryshimi i administratorit dhe administratori i ri është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i subjektit juridik, kontrata e punësimit, midis tyre, me afat jo më të vogël se një vit.

- Dokumenti bankar, që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për lejen.

5. Regjistrimi i lejeve për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave

5.1 Të gjitha të dhënat për lejet, që u janë dhënë subjekteve, regjistrohen në një regjister të veçantë të subjekteve me leje, i cili hartohet, përditësohet dhe publikohet nga sekretaria teknike.

5.2 Sekretaria teknike ruan në arkiv lejen (kopjen për arkivim), së bashku me të gjitha dokumentet e aplikimit dhe praktikant shkresore.

5.3 Çdo subjekt ka të drejtë të konsultohet me të dhënat themelore të regjistrimit të veçantë.

5.4 Subjekti përfitues i lejes, ka detyrimin të paraqesë, menjëherë, pranë njësisë vendore përkatëse, nën juridiksionin e së cilës do të ushtrojë veprimtarinë për administrimin e ndërtesave, kopje të njëzuar të lejes, së bashku me dokumentet respektive, për të kryer regjistrimin në “Librin e administratorëve”.

KREU IV

PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR REGJISTRIMIN NË LIBRIN E ADMINISTRATORËVE E SUBJEKTEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË ADMINISTRIMIT TË NDËRTESAVE

1. Kërkesa për regjistrim në librin e administratorëve i drejtohet kryetarit të njësisë vendore përkatëse dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mësipërm, i kërkuar për personat fizikë ose juridikë.

2. Procedurat administrative për pranimin dhe vlerësimin e dokumenteve e kërkesave të subjekteve për regjistrimin në librin e administratorëve, ose heqjen nga libri ndiqen nga “struktura përkatëse” në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe dispozitat e këtij udhëzimi.

3. Me miratimin e regjistrimit të subjektit, njësia e qeverisjes vendore lëshon dokumentin e regjistrimit, i cili përmban:

3.1 Emrin e personit fizik/juridik.

3.2 Mbishkrimin: “Shoqëri administrimi”, ose “Administrator”.

3.3 Adresën e plotë të selisë dhe degëve.

4. “Struktura përkatëse” që mbulon aktivitetin e regjistrimit të administratorëve/shoqërive administruese ka të drejtë dhe detyrë funksionale:

4.1 Të pranojë kërkesën me dokumentacionin e kërkuar, pasi ka plotësuar paraprakisht formularin e marrë nga zyra e pritjes së popullit.

4.2 Të verifikojë plotësimin e kushteve për regjistrimin e veprimtarisë dhe për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim.

4.3 T’i propozojë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse për regjistrim, në varësi të plotësimit të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim.

4.4 Të lëshojë vërtetimin, që subjekti është njohur dhe regjistruar si administrator/shoqëri administrimi, i cili përmban përveç të dhënave, sipas pikës 3 të këtij kreu edhe datën e lëshimit.

4.5 Të njoftojë subjektin për miratimin ose refuzimin e regjistrimit.

5. Kërkesa e subjektit konsiderohet e dorëzuar, duke filluar nga data e dorëzimit të kërkesës të plotësuar me dokumentet shoqërues, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.



6. “Struktura përkatëse” brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës prej subjektit të interesuar, duhet të shprehet zyrtarisht me shkrim për miratimin ose refuzimin e kërkesës së tij për regjistrim.

7. “Struktura përkatëse” regjistron praktikën në një regjistër vjetor, sipas muajit të vitit kalendarik të dorëzimit. Dokumentacioni ruhet nga kjo strukturë për një periudhë 10-vjeçare dhe dorëzohet me kalimin e këtij afati, në Arkivin Qendror.

8. Në rastin e mosmiratimit të kërkesës për regjistrim, subjektit i lind e drejta e ankesës sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

KREU V

PROCEDURAT E HEQJES SË LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE NË BASHKËPRONËSI

1. Heqja e lejes për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave në bashkëpronësi, bëhet:

1.1 Me vendim të komisionit, kur subjekti ka kryer shkelje sipas kreut VII, pika 1.

1.2 Me vendim të gjykatës të formës së prerë, ku subjekti është shpallur fajtor për abuzime financiare.

2. Në çdo rast personat fizikë dhe juridikë, të hequr nga libri i administratorëve kanë të drejtën e ankimimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

KREU VI

MBIKËQYRJJA E VEPRIMTARISË SË ADMINISTRATORIT/ SHOQËRISË ADMINISTRUESE

1. Kryesia e asamblesë së bashkëpronarëve kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratorit/shoqërisë administruese për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesës.

2. Mbikëqyrja kryhet për të gjitha veprimtaritë e parashikuara në kontratën e lidhur ndërmjet asamblesë së bashkëpronarëve dhe administratorit/shoqërisë administruese.

3. Kryesia e asamblesë njofton një herë në vit, në mbledhjen e asamblesë së bashkëpronarëve mbi veprimtarinë e administratorit/shoqërisë administruese.

4. Në rastet kur kryesia, gjatë mbikëqyrjes, vëren shkelje të kontratës, apo dëme me pasoja ekonomike, njofton asamblesën e bashkëpronarëve dhe bazuar në vendimin e marrë nga asambleja, paraqet pranë njësies së qeverisjes vendore përkatëse, kërkesën për marrjen e masave ligjore për administratorin/shoqërinë administruese, ose bën kallëzim penal në prokurorinë e rrethit, ku ndodhet objekti i administrimit.

KREU VII

MASAT LIGJORE NDAJ SUBJEKTEVE

1. Njësia vendore përkatëse, me kërkesë të kryesisë së asamblesë, fillon procedurat për marrjen e masave ligjore, nëse administratorët/shoqëritë administruese, gjatë përmbushjes së veprimtarisë së tyre kryejnë veprime, që vijnë në kundërshtim me:

1.1 Rregulloren e Këshillit të Ministrave “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”.

1.2 Udhëzimet e ministrit, që sanksionojnë detyrimet e përgjegjësitë e tyre.

1.3 Kushtet e kontratës së lidhur midis tyre dhe kryesisë së asamblesë.

1.4 Çdo dispozitë tjetër ligjore e nënligjore në fuqi.

2. “Struktura përkatëse”, kur ka ankesa nga kryesia e asamblesë, bën verifikimin në vend të çështjes së ankimuar dhe njofton administratorin/shoqërinë administruese për fillimin e procedurave disiplinore.

3. Administratori/shoqëria administruese njoftohet me postë, të paraqitet për dëgjim pranë strukturës përkatëse, jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës nga asambleja e bashkëpronarëve.

4. Njoftimi përmban arsyet e ankesës së asamblesë së bashkëpronarëve dhe datën e paraqitjes së tij për dëgjim pranë strukturës, datë e cila duhet të caktohet 10 ditë mbas dërgimit të njoftimit në mënyrë, që administratori të përgatitet për mbrojtjen e tij.

5. Seanca dëgjimore zhvillohet në prani të strukturës përkatëse, kryesisë së asamblesë, a personit të autorizuar prej tyre dhe administratorit/shoqërisë administruese. Të dyja palët kanë të drejtën e mbrojtjes në seancat e dëgjimit.



6. “Struktura përkatëse”, mbas seancës dëgjimore, propozon për marrjen e masave, në përputhje me masën e shkeljes dhe dëmin e shkaktuar asamblesë së bashkëpronarëve. Struktura përkatëse mund të propozojë:

6.1 Vërejtje me shkrim, për shkelje, që nuk kanë sjellë dëm ekonomik për asamblenë e bashkëpronarëve dhe kryhen për herë të parë.

6.2 Vërejtje me paralajmërim, për shkelje, që nuk kanë sjellë dëm ekonomik, të përsëritura, brenda një periudhe 6-mujore.

6.3 Njofton kryetarin e qeverisjes vendore, për rastet e shkeljeve me pasojë dëmin ekonomik.

7. Njësia e qeverisjes vendore i propozon Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për heqje të lejes për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave në bashkëpronësi, si dhe heq nga libri i administratorëve personat fizikë dhe juridikë, në rastet kur konstatohen shkelje sipas kreut VII, pika 1, të këtij udhëzimi.

8. Komisioni, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, shqyrton në mbledhjet e tij të gjitha rastet e konstatuara dhe të njoftuara nga subjekte shtetërore apo private për shkelje të subjekteve me leje, gjatë ushtrimit të aktivitetit.

9. Komisioni, pasi merr parasysh shkallën e parregullsisë së njoftuar dhe raste të konstatimit të shkeljeve, në mënyrë të përsëritur, që konsistojnë në kryerjen e veprimeve, që vijnë në kundërshtim me:

a) Rregulloren e Këshillit të Ministrave “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”.

b) Udhëzimet e ministrit, që sanksionojnë detyrimet e përgjegjësitë e tyre.

c) Kushtet e kontratës së lidhur midis tyre dhe kryesisë së asamblesë.

d) Çdo dispozitë tjetër ligjore e nënligjore në fuqi.

10. Komisioni merr vendime ndaj subjekteve të pajisur me leje, duke vendosur sanksionet:

- Masën “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Pezullim të përdorimit të lejes, për një afat deri në 6 muaj”, kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara në njërën apo disa nga pikat e këtij neni, por jo në mënyrë të përsëritur.

- Masën “Pezullim të përdorimit të lejes, për një afat nga 6 muaj deri në 2 vjet”, kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara në njërën apo disa nga pikat e këtij neni (“a”, “b”, “c”, “d”), në mënyrë të përsëritur.

- Masën “Heqje të lejes” për rastet kur janë konstatuar shkeljet e përcaktuara në pikat e këtij neni (“a”, “b”, “c”, “d”) edhe pasi subjekti ka ezauruar kohën e sanksionit nga një pezullim i mëparshëm.

11. Sekretaria teknike, për të gjitha rastet kur komisioni vendos sanksionet e mësipërme ndaj subjekteve të pajisura me leje, njofton subjektin e penalizuar, reflekton këtë, menjëherë në listën e publikuar dhe njofton njësinë e qeverisjes vendore për reflektimin e masës në “Librin e administratorëve”. Gjithashtu, i komunikon zyrtarisht vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

12. Çdo subjekt ka të drejtën e ankimit tek titullari i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për këto raste;

a) Kur refuzohet kërkesa për pajisje me leje ndaj subjektit.

b) Kur ndaj subjektit është marrë një vendim nga komisioni për rastet e përmendura në pikën 31 të kësaj rregullore.

13. Për çdo vendim të komisionit, subjektet e interesuara, kanë të drejtën e ankimit te Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, brenda 30 ditëve, nga data e njoftimit. Titullari i Ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos brenda 10 ditëve:

- mospranimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni.

- kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në komision.

14. Ndaj vendimit të Ministrit apo vendimit përfundimtar të Komisionit, në rast se subjekti nuk është dakord, i lind e drejta, që brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, të bëjë ankim në gjykatë.

15. Asambleja e bashkëpronarëve mund të bëjë edhe kallëzim penal në prokurorinë e rrethit, ku ndodhet objekti i administrimit, për shkelje me dëm ekonomik, që administratori /shoqëria e administrimi ka bërë ndaj asamblesë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermani



Lidhja nr. 1

VETËDEKLARIM

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave, që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e Prokurorisë, në lidhje me profesionin, ku kërkoj të pajisem me leje për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin e banesave, (ose në rast se ka – deklaroj : Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

Deklaruesi

UDHËZIM

Nr. 4441/2, datë 19.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 6257, DATË 2.9.2008 “MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET, QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” i ndryshuar, dhe nenit 1 të aktit normativ nr. 3/2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në referencën ligjore hiqet shprehja “...si dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe

funksionarëve politikë”. Në referencën ligjore, në fund, shtohet shprehja “...dhe nenit 1 të aktit normativ nr. 3/2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”.

2. Kudo në përmbajtje të këtij udhëzimi, ku përmendet “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit”, zëvendësohet me “Ministria që mbulon fushën e strehimit”.

3. Pika 1, ndryshon si më poshtë:

a) Pas fjalës “...i ndryshuar...” shtohet shprehja “dhe akti normativ nr. 3/2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”.

b) Pas shprehjes “..interesi 3%..” shtohet shprehja “...dhe 0%...”.

4. Pika 1.1 hiqet.

5. Në fund të pikës 2, shtohet paragrafi “Ministria e Financave dhe Ministria që mbulon fushën e strehimit kanë të drejtën të rishikojnë marrëveshjen ekzistuese me bankën e përzgjedhur për kreditimin, ose të lidhin kontratë të re me bankë tjetër, që ofron kushte më të leverdisshme.”, pa cenuar kushtet e marrëveshjes së lidhur me bankën e përzgjedhur.

6. Në pikën 3, pas togfjalëshit “..që duhet të ndjekin...” shtohet shprehja “.. bashkitë dhe Enti Kombëtar i Banesave, sipas këtij udhëzimi dhe tabelave e shtojcave bashkëlidhur...”.

7. Në pikën 4, bëhen këto ndryshime:

a) shprehja “..e banesave me kosto të ulët dhe kanë të ardhura mesatare mujore, sipas tabelës bashkëlidhur...” zëvendësohet me togfjalëshin “... e kreditimit të lehtësuara dhe kanë të ardhura mesatare mujore të llogaritura, sipas nenit 19 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004” të ndryshuar,..”.

b) në fund të pikës, hiqet shprehja “brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi” dhe shtohet togfjalëshi “Këto familje paguajnë principialin e kredisë me interes 3%...”.

8. Pas pikës 4, shtohet pika 4.1 me përmbajtje “Masa e subvencionit të interesave të kredisë (subvencioni), për familjet, sipas ligjit nr. 9232, të jetë e barabartë me diferencën midis interesit vjetor të kredisë (sipas marrëveshjes), me interesin 3%. Këto familje paguajnë principialin e kredisë dhe interesin 3%...”.



9. Në pikën 5, pas shprehjes “...të përcaktuara..”, shtohet fjala “...çdo vit...”.

10. Në pikën 6, fjalia e dytë riformulohet si më poshtë:

“Për verifikimin e të dhënave, si më sipër, familjet paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012, “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”. Zyrat përkatëse, në bashki, kryejnë verifikimet sipas legjislacionit në fuqi për dokumentacionin e paraqitur si më sipër dhe marrin konfirmim nga Zyra Qendrore dhe Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pasuri, të regjistruara në emër të gjithë anëtarëve të familjes.”.

11. Pika 7 ndryshon si më poshtë:

“Për familjet sipas aktit normativ nr. 3, që përfshihen edhe në germën “a” të nenit 5 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, i ndryshuar, Ministria, që mbulon fushën e strehimit, bashkëpunon për të gjetur zgjidhje të përshtatshme me Bankën që do të kreditojë, në favor të aplikuesit, në rastet kur familja nuk arrin të vërtetojë nivelin e të ardhurave të kërkuar nga kjo e fundit.”.

12. Pas pikës 7, shtohet një paragraf me përmbajtje si më poshtë:

“Masa e subvencionit të interesave të kredisë (subvencioni), për familjet, sipas aktit normativ nr. 3, të jetë e barabartë me interesin vjetor të kredisë në tregun e lirë, sipas marrëveshjes. Këto familje paguajnë vetëm principalin e kredisë me interes 0%.”

13. Pika 7/1, riformulohet si më poshtë:

“Për efekt të përfitimit të subvencionit, familjet, që përfshihen në pikën 7 të këtij udhëzimi, paraqiten pranë zyrave rajonale të Entit Kombëtar të Banesave (EKB) për rifreskimin e dokumentacionit si më poshtë:

a) Vërtetim negativ nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare, të datës 1.12.1992, nuk figuron banesë e regjistruar, ose në proces regjistrimi;

b) Asnjë anëtar i familjes, që përfiton kredi të lehtësuar, të mos jetë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, si biznes i madh;

c) Vërtetimin për përfitimin e statusit “banor në ish pronë private”, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, përpara vitit 2006;

d) Certifikatën e gjendjes familjare të datës 1 dhjetor 1992 dhe atë aktuale;

e) Adresën e banesës /dhe emrin e pronarit të banesës.”.

14. Pika 7/2, riformulohet si më poshtë:

“Qytetarët të cilët nuk janë përfshirë në listat e dërguara nga Bashkitë përkatëse e, respektivisht nuk kanë përfituar statusin me vendim të Këshillit Bashkiak, për t’u përfshirë në programin e kreditimit me interes 0 % duhet që, përveç dokumentacionit të pikës 10 (“a”, “d” dhe “e”), të depozitojnë pranë zyrave përkatëse të EKB-së dokumentacionin shtesë të mëposhtëm:

a) Kopje të kontratës së qiramarrjes (me ish-Ndërmarrjen Komonale Banesa)/ose/ autorizim apo vendim të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv (origjinale ose të noterizuara)/ ose akti i dhënies dhe marrjes në dorëzim të banesave shtetërore/apo çdo dokument tjetër të shërbyer zyrtarisht nga ish-komonale banesa, që vërteton lidhjen mes banesës së kthyer pronarit dhe qiramarrësit.

b) Vendim i kthimit të pronës nga Komisioni i Kthimit të Pronave pronarit të ligjshëm (origjinale ose të noterizuara)/ose /vendim gjykate në të cilin vërtetohet, se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm /ose / dokument të lëshuar nga ish-N.K.Banesa për kalim prone, në favor të pronarëve/ose/ certifikatë apo vërtetim pronësie në favor të pronarit (origjinale ose e noterizuar)/ ose urdhër ekzekutimi, të lëshuar nga gjykata e rrethit për lirimin e banesës pronarit të ligjshëm, në zbatim të aktit normativ nr. 3.”.

15. Në pikën 7/2/1, germat “b” e “c” ndryshojnë si më poshtë:

“b) Familjet, që banojnë në banesat e emigrantëve politikë dhe ekonomikë, të cilat, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 7/1, duhet të plotësojnë edhe dokumentacionin:

- autorizim/dokument të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i qytetit/këshilli popullor i lagjes;

- certifikatë apo vërtetim pronësie në favor të pronarit/ose/ vendim gjykate në të cilin vërtetohet se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm dhe qytetari është i pastrehë



(Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.).

c) Familjet qiramarrëse, banuese në ish-pronë private në qiramarrje me pronarin, para vitit 1992, të cilat, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 8 të këtij udhëzimi, duhet të plotësojnë dokumentacionin si më poshtë:

- autorizim/ose/dokument të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i lagjes/ këshilli popullor i lagjes;

- certifikatë apo vërtetim pronësie në favor të pronarit/ose/vendim gjykatë, në të cilin vërtetohet se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm dhe qytetari është i pastrehë (Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.).

16. Në pikën 7/2/1, shtohet germa “d”, me përmbajtje:

“Familjet e policëve të vrarë në detyrë, të cilët paraqesin dokumentacionin përkatës nga Ministria e Brendshme”.

17. Pika 7/2/4, ndryshon si më poshtë:

“Enti Kombëtar i Banesave (EKB), në dosjet që krijon për çdo qytetar të përfshirë në pikat 7, 7/2, 7/2/1, 7/2/2 dhe 7/2/3 të këtij udhëzimi, krahas dokumentacionit të pikave 10, 11 dhe 12, të depozitohet edhe procesverbalin e verifikimit në vend, të bërë nga komisionet e ngritura prej tij, përpara se të dërgojë kërkesën për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit. Procesverbali do të përmbajë këto të dhëna:

- Nëse familja jeton apo jo si qiramarrëse në banesën ish-pronë e subjekteve të shpronësuar;

- Mundësitë e familjes qiramarrëse për strehim, në një nga programet sociale të strehimit, që përcakton ligji, apo nevoja për strehim në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta;

18. Në pikën 7/3, bëhen këto ndryshime:

a) Togfjalëshi “Listat e familjeve që përfshihen në pikën 7,…” bëhet “Listat e familjeve, që përfshihen në pikat 7, 7/2, 7/2/1, 7/2/2 dhe 7/2/3 të këtij udhëzimi”.

b) Në fjalinë e fundit pas togfjalëshit “EKB njofton menjëherë bashkitë respektive…” shtohet fjala “Ministrinë që mbulon fushën e strehimit…”.

19. Pika 7/4, pas togfjalëshit “...sipas certifikatës familjare..”, ndryshon si më poshtë:

“... të datës 01.12.1992. Vlera e kredisë, që

përfiton familja përcaktohet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij projektudhëzimi. Kjo tabelë pasqyron “Kufirin maksimal të kredisë, që llogaritet sipas qyteteve dhe strukturës që përfiton familja”. Tabela i bashkëlidhet udhëzimit e përditësohet me nivelin e çmimit mesatar të shitblerjes së apartamenteve në treg, miratuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për çdo vit, në VKM-në nr. 814, datë 3.12.2004 “Për normat e strehimit”, për rastet e veçanta të parashikuara në pikën 4 të kësaj VKM-je, dhe VKM-në nr. 257, datë 6.8.2014”, “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për përfitim të garantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët”.

20. Pas pikës 7/7, shtohet pika 7/8 me përmbajtje si më poshtë:

“7/8 Banka vijon me procedurat e kreditimit pas konfirmimit zyrtar të listave nga Ministria.”.

21. Në pikën 8 shprehja “i dërgohet bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit”, bëhet “i dërgohet bankës, ministrisë që mbulon fushën e strehimit dhe EKB-së, si dhe publikohet nga bashkia me një nga mjetet e informimit publik”.

22. Në pikën 10, togfjalëshi “... e vlerës së banesës...” zëvendësohet me shprehjen “...e vlerës së kredisë...”

23. Në fjalinë e fundit të pikës 11, pas togfjalëshit “...përditësohen çdo vit...”, shtohet shprehja “nga bashkitë”, dhe shprehja “...dhe publikohen...” bëhet “...që publikohen...”.

24. Në pikën 17, bëhen këto ndryshime:

a) Togfjalëshi “...« Strehimi & Urbanistika »..”, zëvendësohet me “... .. “Planifikimi Urban dhe Strehimi”..”

b) Në germën “c”, togfjalëshit “...banka dërgon...” ndryshon “...banka i dërgon Ministrisë që mbulon fushën e strehimit dhe Entit Kombëtar të Banesave...”.

25. Në pikën 18, togfjalëshi: “...çdo tremujor...” ndryshon dhe bëhet “...çdo 1 muaj...”

26. Në pikën 19, bëhen këto ndryshime:

a) Hiqet togfjalëshi “...dhe e dokumentacionit që shoqëron çdo kontratë....”



b) Hiqen dy fjalitë e fundit me përmbajtje “Për këtë shërbim, EKB përfiton 1% të fondit të subvencionit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve operative. Kjo shumë mbahet mbi çdo disbursim të subvencionit që EKB i bën bankës, sipas pikës 18”, dhe zëvendësohen me fjalinë “EKB informon rregullisht Ministrinë që mbulon fushën e strehimit mbi ecurinë e procesit dhe gjetjeve nga verifikimet e kryera”.

27. Në pikën 19/1, bëhen këto ndryshime:

a) Pas shprehjes “EKB njofton..” shtohet shprehja “Ministrinë që mbulon fushën e strehimit dhe...”

b) Pas germës “c” shtohen germa d dhe e, me përmbajtje: d) ka mangësi në një nga dokumentet e kërkuar nga VKM 574/2012 e paraqitur bashkisë, i cili nuk plotësohet brenda 60 ditëve nga njoftimi për plotësimin e dokumentacionit.

e) Në rastet kur konstatohen mospërmbushje sipas germës “d” më sipër, EKB i propozon Ministrisë që mbulon fushën e strehimit dhe Ministrisë së Financave rishikimin e marrëveshjes së lidhur me bankën”.

28. Në pikën 19/2, togfjalëshi “...pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.” zëvendësohet me shprehjen “sipas këtij udhëzimi”.

29. Pas pikës 19/2, shtohet pika 19/3 me përmbajtje:

“EKB, bazuar në dokumentacionin dërguar nga banka sipas pikës 17, si dhe në listat e miratuara nga këshillat bashkiakë, njofton çdo 3 muaj Ministrinë që mbulon fushën e strehimit dhe bashkitë respektive, mbi numrin e kontratave të lidhura dhe numrin e rasteve të refuzuara nga banka, shoqëruar me arsyet e refuzimit.”

30. Pikat 20, 21, 21/1, 21/3, shfuqizohen.

31. Pika 21/2 bëhet pika 20.

32. Pika 21/4 bëhet pika 21.

33. Në pikën 22, bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të paragrafit të parë, hiqet togfjalëshi “...dhe kriteret e përcaktuara në pikat 5 e 6 të VKM nr. 600 datë 12.9.2007.”;

b) Hiqet paragrafi i fundit me përmbajtje “Shuma e kredisë për të cilën mund të subvencionohen nuk mund të jetë më e madhe se ajo e përcaktuar në këtë udhëzim dhe në shkresat e institucioneve përkatëse për subjektet që përfitojnë sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007.”

34. Pika 24 riformulohet si më poshtë:

“Për lidhjen e kontratës me bankën, familjet, emrat e të cilëve janë miratuar me vendim të këshillave bashkiake dhe i janë dërguar bankës, kanë një afat prej 6 muaj nga data e njoftimit zyrtar që bashkia i bën të interesuarit. Afati 6-mujor fillon me datën e protokollimit të shkresës së dërguar nga bashkia, institucioneve përfshirëse, sipas pikës 21 të këtij udhëzimi. Në rast se para përfundimit të afatit 6-mujor, familja ende nuk ka gjetur banesë, paraqitet pranë EKB-së për të kërkuar shtyrje të afatit. Kjo e fundit njofton bankën për shtyrjen e afatit dhe vë në dijeni Ministrinë që mbulon fushën e strehimit.”.

35. Pika 25 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

“Në rast se familja nuk paraqitet brenda 6-muajve, ministria që mbulon fushën e strehimit i kërkon bashkive dërgimin e një liste të dytë për plotësimin e numrit të kuotave të përcaktuara për atë vit buxhetor.”.

36. Pas pikës 26 shtohen pikat 27- 31, me përmbajtje si më poshtë:

“27. Pas tejkallimit të afatit 1 vjeçar (6+ 6 muaj) familja humbet të drejtën për lidhjen e kontratës me bankën dhe riaplikon pranë bashkisë për të përfituar nga programet e strehimit.

28. Në rastet kur për arsye objektive, shkak për bllokimin, pezullimin apo ndërprerjen e përkohshme të kreditimit dhe për tejkallimin e këtyre afateve (6+6muaj), bëhet njëri nga palët e marrëveshjes së lidhur, nuk llogaritet koha nga momenti i bllokimit deri në rifillimin e procedurave.

29. Në rastet kur paraqiten situata të përcaktuara në pikën 28, ngarkohet Ministria që mbulon fushën e strehimit për të shqyrtuar, trajtuar dhe vlerësuar rast pas rasti aplikimet e miratuara nga këshillat bashkiakë dhe që paraqesin emergjencë, me qëllim vijimin e procedurave të kreditimit të lehtësuar.

30. Për vlerësimin dhe trajtimin e rasteve emergjente dhe lejimin e vijimit të procedurave për kreditimin e lehtësuar, Ministri që mbulon fushën e strehimit, me urdhër të veçantë/posaçëm ngre komisionin e shqyrtimit të kërkesave. Ky komision vlerëson dhe miraton vazhdimin e procedurave të kreditimit të lehtësuar për këto raste.



31. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm, mbi të cilin vlerëson komisioni, përcaktohen në urdhrin e Ministrit që mbulon fushën e strehimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Tabela 1.					
Qyteti	Struktura e familjes (nr perona)	Struktura e apartamentit	Siperfaqja e apartamentit m ²	*Vlera mesatare e shitblerjes se baneses ne tregun e lire sipas Udhhezimit te KM per koston mesatare, (miratuar per cdo vit)	**Kufiri maksimal I kredise
1	2	3	4	5	4*5
Tirane	2	G	42		
	3	1+1	50		
	4	2+1	62		
	5-6	3+1	80		
Dures	2	G	42		
	3	1+1	50		
	4	2+1	62		
	5-6	3+1	80		
* Cmimi I tregut per vitin 2014 percaktohet bazuar ne Udhhezimin nr. 2, date 6.8.2014					
** Kufiri maksimal I kredise llogaritet duke shumezuar siperfaqen e apatamentit te perfituar me vleren mesatare te shitblerjes sipas qyteteve dhe e miratuar cdo vit.					

VENDIM
Nr. 110, datë 18.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 79, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes të energjisë elektrike”, ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të

Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015, si dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015.



2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 111, datë 18.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 80, datë 26.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015, si dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit me pakicë,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 112, datë 19.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE 2015 PËR OST SHA

Në mbështetje të neneve 9, 24, dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.11.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga OST sh.a. ka mangësi dhe plotësime që duhet të bëhen në mënyrë që grupit të punës së ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 74, datë 10.10.2014, t'i mundësohet një gjykim i drejtë për propozimin e miratimit të planit të investimeve. Për këtë arsye OST sh.a.-së i janë bërë me dije kërkesat e ERE-s për përmirësimin e dokumentacionit të aplikimit si më poshtë:

- Në zbatim të nenit 7 paragrafi 3, kërkesa për miratim të planit të investimeve duhet të shoqërohet me një raport të zbatimit të planit paraardhës ku tregohet ecuria e investimeve të planifikuara dhe shpjegime rreth çdo ndryshimi.

- Viti 2014 është viti i fundit i periudhës së tretë rregullatore, e për këtë arsye është e nevojshme që të paraqitet një raport i detajuar lidhur me planifikim/realizimin për periudhën 2012-2014. Duhet të paraqiten investimet e planifikuara/realizuara të vitit dhe do të shoqërohen me një shpjegues lidhur me investimet e parashikuara por që nuk janë realizuar dhe shpjegime për investimet e paparashikuara në planin e miratuar por të realizuara.



- Plani i investimeve për vitin 2015 duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me shpjegime e të dhëna të mjaftueshme lidhur me investimet afatgjata që planifikohen.

- Kërkohet që të dokumentohet miratimi i planit të investimeve 2015 nga këshillat mbikëqyrës përkatës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për OST sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 113, datë 19.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE 2015 PËR KESH SHA

Në mbështetje të neneve 9, 24, dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.11.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga KESH sh.a. ka mangësi dhe plotësime që duhet të bëhen në mënyrë që grupit të punës së ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 74 datë 10.10.2014, t’i mundësohet një gjykim i drejtë për propozimin e miratimit të planit të investimeve. Për këtë arsye KESH sh.a.-së i janë bërë me dije kërkesat e ERE-s për përmirësimin e dokumentacionit të aplikimit si më poshtë:

- Në zbatim të nenit 7 paragrafi 3, kërkesa për

miratim të planit të investimeve duhet të shoqërohet me një raport të zbatimit të planit paraardhës ku tregohet ecuria e investimeve të planifikuara dhe shpjegime rreth çdo ndryshimi.

- Viti 2014 është viti i fundit i periudhës së tretë rregullatore, e për këtë arsye është e nevojshme që të paraqitet një raport i detajuar lidhur me planifikim/realizimin për periudhën 2012-2014. Duhet të paraqiten investimet e planifikuara/realizuara të vitit dhe do të shoqërohen me një shpjegues lidhur me investimet e parashikuara, por që nuk janë realizuar dhe shpjegime për investimet e paparashikuara në planin e miratuar, por të realizuara.

- Plani i investimeve për vitin 2015 duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me shpjegime e të dhëna të mjaftueshme lidhur me investimet afatgjata që planifikohen.

- Natyrisht kërkohet që të dokumentohet miratimi i planit të investimeve 2015 nga këshillat mbikëqyrës përkatës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për KESH sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 114, datë 19.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE 2015 PËR OSHEE SHA

Në mbështetje të neneve 9, 24 dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.11.2014, pasi



shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga OSHEE sh.a. ka mangësi dhe plotësime që duhet të bëhen në mënyrë që grupit të punës së ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 74 datë 10.10.2014, t'i mundësohet një gjykim i drejtë për propozimin e miratimit të planit të investimeve. Për këtë arsye OSHEE sh.a.-së i janë bërë me dije kërkesat e ERE-s për përmirësimin e dokumentacionit të aplikimit si më poshtë:

- Në zbatim të nenit 7 paragrafi 3, kërkesa për miratim të planit të investimeve duhet të shoqërohet me një raport të zbatimit të planit paraardhës, ku tregohet ecuria e investimeve të planifikuara dhe shpjegime rreth çdo ndryshimi.

- Viti 2014 është viti i fundit i periudhës së tretë rregullore, e për këtë arsye është e nevojshme që të paraqitet një raport i detajuar lidhur me planifikim/realizimin për periudhën 2012-2014. Duhet të paraqiten investimet e planifikuara/realizuara të vitit dhe do të shoqërohen me një shpjegues lidhur me investimet e parashikuara por që nuk janë realizuar dhe shpjegime për investimet e paparashikuara në planin e miratuar por të realizuara.

- Plani i investimeve për vitin 2015 duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me shpjegime e të dhëna të mjaftueshme lidhur me investimet afatgjata që planifikohen.

- Natyrisht kërkohet që të dokumentohet miratimi i planit të investimeve 2015 nga këshillat mbikëqyrës përkatës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të investimeve 2015 për OSHEE sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 20, datë 20.10.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS ORIKUM

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit sh.a Ujësjiellës Orikum, me:

- Drejtues ligjor: Mynyr Hodo;

- Drejtues teknik: Valbona Ibrushi.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Orikum autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Orikum.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 19.11.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 21, datë 14.11.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS KURBIN

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit sh.a Ujësjiellës Kurbin, me:

- Drejtues ligjor: Kastriot Marku;
- Drejtues teknik: Julinda Elezi.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Kurbin autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Kurbin, komunat Mamurras, Milot.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 13.11.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 22, datë 14.11.2014

**PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES
SË PAGESËS RREGULLATORE
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, neni 10, pika 1 dhe metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, neni 13, pika 2, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Pagesa rregullatore për operatorët që u miratohet ndryshimi i tarifave për vitin 2015 do të jetë 0.6% e të ardhurave të parashikuara për të gjithë operatorët.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2015.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 159, datë 1.12.2014

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT
KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE NË QARKUN Vlorë, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI
I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 01.12.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, në Qarkun Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të Znj. Luiza Xhuvani.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 3863 prot., datë 27.11.2014, drejtuar KQZ-së, Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Luiza Xhuvani, deputete e zonës zgjedhore Qarku Vlorë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ për krijimin e vakancës dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 31, datë



2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Vlorë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 6 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Qarkun Vlorë, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Edi Rama, me numër rendor 2 (dy) Valentina Leskaj, me numër rendor 3 (tre) Koço Kokëdhima, me numër rendor 4 (katër) Luiza Xhuvani, me numër rendor 5 (pesë) Fatmir Toçi, me numër rendor 6 (gjashtë) Andrea Marto.

Rezulton se Lista Shumemërore e Partisë Socialiste në Qarkun Vlorë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës mandati i përkiste kandidates znj. Luiza Xhuvani e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës KQZ do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ, me vendimin nr. 337, datë 11.05.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas zonjës Luiza Xhuvani që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PS në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore Qarku Vlorë, rezulton se kandidatja e radhës sipas deklaratimit është kandidatja me numër rendor 9 (nëntë) znj. Mira Qemal Shehu.

Për sa më sipër, mandat i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 9 (nëntë) znj. Mira

Qemal Shehu të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Vlorë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste Qarku Vlorë, znj. Mira Qemal Shehu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KËRKESË

Nr. 7302, datë 1.12.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (objekte, lotet 6,7,8,11)”.

Subjekti kerkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në



pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit “objekt”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë

22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 81 456 667 (tetëdhjetë e një milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT “PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË” LOTI 6 (OBJEKTE)

Nr.	Pronari			Z. K	Nr.	EMËRTIMI I	SIP.(M²)	OBJEKTE	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
					Pas.	OBJEKTEVE	OBJEKTET	VLERA SIPAS PREVENTIVIT (lekë)	
1	Ilmi		Parllaku	3204	68/116	Shesh		380058	Leje ndërtimi
2	Isa		Veza	3204	68/38	Shesh		448487	Leje ndërtimi
3	Dritan		Kanapari	8551	5/192	Shesh		273576	Leje ndërtimi
4	Shaban		Tatani	3204	68/14	Lokal 1kt	68.5	1327090	certifikatë pronësie
5	Izet	Rustem	Tatani	3204	169/21	Banesë 2kt	321.4	8493720	certifikatë pronësie
6	Nuredin	Halit	Daiu	3554	308/21	Banesë 2kt	274.2	5831298	Certifikatë pronësie
7	Muhamet		Shkodra	8551	5/387	Shesh		415091	Leje ndërtimi
8	Ymer		Xhahysa	3554	310/33	Shesh		529577	Leje ndërtimi
9	B.p. Bajaziti			8551	5/110	Shesh		756150	Leje ndërtimi
			TOTALI					18,455,047	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË”
LOTI 7, 8 DHE 11 (OBJEKTET)

Nr.	Emri - atësia - mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr.i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (lekë)	Shënime
1	Jani Kristo Papa	8552	12/287	115.6	Ndërtësë 1 kt Loti 7	4,251,851	Certifikatë pronësie
2	Murat Haqim Çelhaka	3818	18/102		Shesh+rrethim Loti 8	3,004,501	Certifikatë pronësie
3	Vullnet Ramiz Dedja	3817	18/110		Shesh+rrethim Loti 8	2,504,191	Certifikatë pronësie
4	Bardhyl Riza Tola	3817	14/34		Shesh+rrethim Loti 8	2,198,898	Certifikatë pronësie
5	Bardhyl Riza Tola	3817	15/25		Shesh+rrethim Loti 8	1,061,930	Certifikatë pronësie
6	Bardhyl Riza Tola	3817	14/39		Shesh+rrethim Loti 8	817,546	Certifikatë pronësie
7	Rozeta Baha	3817	18/64		Karburant (pjesërisht)	7,285,157	Certifikatë pronësie
8	Kujtim Kurti	3817	15/21		Shesh+rrethim Loti 8	438,513	Certifikatë pronësie
9	Mendrin Mehdi Dervishi	3817	17/245		Shesh+rrethim Loti 8	1,084,746	Certifikatë pronësie
10	Agim Dogjani	3427	26/7		Karburant "Eurodrin" (pjesërisht) Loti 8 majtas	4,398,326	Konfirmim ZVRPP
11	Shoqëria "Eurodrin" sha Shyqyri Duraku	3427	7\17, 7\18		Karburant "Eurodrin" (pjesërisht) Loti 8 djathtas	4,021,021	Konfirmim ZVRPP
12	Mersin Hysen Sinameta	3427	46/40	68	Karburant Loti 8	7,735,417	Konfirmim ZVRPP
13	Nazmi Sali Cepeli	3427	46/34		Shesh+rrethim Loti 8	487,155	Leje ndërtimi
14	Durim Sali Cepeli	3427	46/30		Shesh+rrethim Loti 8	459,900	Leje ndërtimi
15	Genci Sali Cepeli	3427	46/33		Shesh+rrethim Loti 8	499,846	Leje ndërtimi
16	Llazar Sotir Angjeli Gugash Magani	3235	259/38		Karburant "Anoil" majtas (pjesërisht) Loti 11	8,513,231	Konfirmim ZVRPP



17	Gugash Magani	3235	259/54		Karburant "Anoil" djathtas (pjesërisht) Loti 12	2,896,462	Leje ndërtimi
18	Sami, Ramazan & Arif Daja	3235	259/50		Shesh Loti 11	1,932,470	Leje ndërtimi
19	Egerem Deliu	3235	245/10		Karburant "API" Loti 11	7,685,798	Konfirmim ZVRPP
20	Maliq Hajrullah Kullolli	3235	259/26		Shesh Loti 11	390,879	Leje ndërtimi
21	Rrahman Abdyl Hyka	1815	245/7		Shesh Loti 11	300,896	Leje ndërtimi
22	Ruzhdi Hajdar Proshka	1815	261/54		Shesh Loti 11	1,032,886	Konfirmim ZVRPP
	SHUMA TOTALE					63,001,620	

KËRKESË**Nr. 7364, datë 3.12.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe e Tiranës,, (objekte)”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “objekt dhe truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUTURËS
Edmond Haxhinasto**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT” (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE TIRANË, OBJEKTE), SHITESA

Nr.	Emri - atësia - mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m ²)	Sipërfaqe e truallit (m ²)	Çmimi truallit (lek/m ²)	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale (lekë)	Shëni me
1	Subjekti ndërtues "MAREG" Investitori Pavlin Kalusha	8160	5//84	Objekt polifunksional	1289				30357710	30,357,710	Leje ndërtim i
2	Fatos Babo +bp.	8160	5//84	Truall		396	57126	22621896		22,621,896	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE									52,979,606	

**KËRKESË****Nr. 7402, datë 4.12.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bashkia Kamëz-Ura Tapizë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit, “arë, truall dhe objekt”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 22 214 513 (njëzet e dy milionë e dyqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUTURËS
Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve për shpronësimin e pasurive, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Kamez - Tapize". Fshati Qerekë, Krujë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zk.	Nr.pas.	Sip.përgj. m2	Arë m2	Çmimi lek	Vlera lek	Truall m2	Çmimi lek	Vlera lek	Objektet vl.lek	Vlera tot.lek	Shenime
1	Imer		Hidri	3096	107/49	5525 are	232	234	54288					54288	konf.zvrpp
2	Osman		Hidri	3096	107/47	3000 are	210	234	49140					49140	konf.zvrpp
3	Firma "EUROGRAM"			3096	107/30	4000tr.447.3 nd				235	1281	301035	5943055	6244090	konf.zvrpp
4	Xhovalin		Perpali	3096	107/21	1000 are	86	234	20124					20124	konf.zvrpp
5	Gezim		Kolpepaj	3096	107/33	620 are	62	234	14508					14508	konf.zvrpp
6	Bibil		Ndoci	3096	107/27	1000 are	49	234	11466					11466	konf.zvrpp
7	Aleks		Ndoci	3096	107/26	1000 are	77	234	18018					18018	konf.zvrpp
8	Shoqëria ALB pisha			3096	107/38	2120 tr.185 nd				143	1281	183183	303261	486444	konf.zvrpp
9	Bashkpronaret		Luga	3096	107/53	1822 are	124	234	29016					29016	konf.zvrpp
10	Xhemal		Vraja	3096	113/11	4714a.250tr.109nd	179	234	41886					41886	konf.zvrpp
11	Muhammed		Vraja	3096	113/29	1012 tr.256 m2nd.				139	1281	178059	208171	386230	konf.zvrpp
12	Xhimi		Xhixha	3096	113/30	1044 are	214	234	50076					50076	konf.zvrpp
13	Lumturi		Hystuna	3096	113/25	2000 are	209	234	48906					48906	konf.zvrpp
14	Halil		Hidri	3096	113/34	345 are	72	234	16848					16848	konf.zvrpp
15	Xhavit		Hidri	3096	108/27	3000 are	235	234	54990					54990	konf.zvrpp
16	Bajram		Hidri	3096	108/14	4398 are	82	234	19188					19188	konf.zvrpp
17	Neim		Hidri	3096	108/13	3442a.250tr.66nd				218	1281	279258		279258	konf.zvrpp
18	Bashkpronaret		Hidri	3096	108/23	8797a.250tr.77nd	64	234	14976	250	1281	320250		335226	konf.zvrpp
19	Dritan		Kaea	3096	108/25	5390 are	239	234	55926					55926	konf.zvrpp
20	Sadik		Piloci	3096	108/32	1875 are	70	234	16380					16380	konf.zvrpp
21	Bajram		Hidri	3096	108/30	4458 are	143	234	33462					33462	konf.zvrpp
22	Ramiz		Hidri	3096	108/1	7396 are	195	234	45630					45630	konf.zvrpp
23	Naim	Muja		3096	103/31	1000 tr.264 nd.				202	1281	258762		258762	konf.zvrpp
24	Myrteza		Ibrahimllar	3096	103/30	2788 are	146	234	34164					34164	konf.zvrpp
25	Bajram		Hidri	3096	103/5	3690 are	226	234	52884					52884	konf.zvrpp
26	Imer		Hidri	3096	103/6	3160 are	100	234	23400					23400	konf.zvrpp
27	Ferit		Hidri	3096	103/7	4000a.1000tr.225nd				217	1281	277977		277977	konf.zvrpp
28	Ali		Vraja	3096	113/31	2336 are	59	234	13806					13806	konf.zvrpp
29	Firma "GEMINI"sh.p.k.			3096	107/48								634053	634053	leje ndert
30	Bashkp.		Hidri	3096	108/2	1964 are	49	234	11466					11466	konf.zvrpp
31	Fatmir		Selamanaj	3096	107/54	800 are	100	234	23400					23400	konf.zvrpp
32	Shtet			3096	97/9	1140 zhavorishte	112	101	11312					11312	pret.pron
33	Firma "CIPA"sh.p.k.			3096	107/48	38197 zhavorishte							476380	476380	lej nder.
Shuma:									765260			1798524	7564920	10128704	



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista e pronareve per shpronesimin e pasurive,qe preken nga ndertimi I segmentit rrugor"Kamez - Tapize". Qyteti Kamez

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zk.	Nr.pa	Sip.përg	Arë	Çmimi	Vlera	Truall	Çmimi	vlera	objektet	Vlera	Shënime
						m2	m2	lek	lek	m2	lek	lek	vl.lek	tot.lek	
1	Lush		Osmani	2066	344/2	892T,24				214	2650	567100	1700691	2267791	leje ndertimi
2	Enkeleda		Jovani	2066	44/11	2030T,2				239	2650	633350	2183409	2816759	leje ndertimi
3	Azem		Baci	2066	45/20					142	2650	376300	1021179	1397479	leje ndertimi
4	Tasim		Selmani	2066	44/67	3000are				238	2650	630700	209159	839859	leje ndertimi
5	Pal		Kasa	2066	63/54	2196 are				159	2650	421350	371729	793079	leje ndertimi
6	Ferit		Biba	2066	4/65					213	2650	564450	591264	1155714	leje ndertimi
7	Zef		Shtjefni	2066	63/96					226	2650	598900	318092	916992	leje ndertimi
8	Muharrem		Hasani	2066	45/4	5600	22	626	13772					13772	konf.zvrpp
9	Ndue		Alia	2066	45/31	610	29	626	18154					18154	konf.zvrpp
10	Arben		Matoshi	2066	45/30	300	33	626	20658					20658	konf.zvrpp
11	Qazim		Muja	2066	45/1	6300	62	626	38812					38812	konf.zvrpp
12	Marash		Perkola	2066	63/84	4500	20	626	12520					12520	konf.zvrpp
13	Sherif		Halili	2066	63/12	11130	54	626	33804					33804	konf.zvrpp
14	Maliq		Skenderi	2066	5/42	63.2	19	626	11894					11894	konf.zvrpp
15	Shevahir		Skenderi	2066	5/41	606.7	20	626	12520					12520	konf.zvrpp
16	Nairn		Skenderi	2066	5/43	132	17	626	10642					10642	konf.zvrpp
17	Shpetim		Skenderi	2066	5/44	132	21	626	13146					13146	konf.zvrpp
18	Ilir		Skenderi	2066	5/45	132	18	626	11268					11268	konf.zvrpp
19	Besnik		Lamce	2066	5/12	9800	233	626	145858					145858	konf.zvrpp
20	Pellumb		Duksa	2066	5/11	5600	155	626	97030					97030	konf.zvrpp
21	Mirash		Lamthi	2066	5/23	3240	122	626	76372					76372	konf.zvrpp
22	Behar		Lamce	2066	5/7	5600	114	626	71364					71364	konf.zvrpp
23	Shemsi		Prenci	2066	5/5	2800	42	626	26292					26292	konf.zvrpp
24	Shemsi		Prenci	2066	5/54	4650	101	626	63226					63226	konf.zvrpp
25	Bashkp.Cupi			2066	83/19	2800	15	626	9390					9390	konf.zvrpp
26	Bashkp.Cupi dhe Valtër			2066	83/22	5600	33	626	20658					20658	konf.zvrpp
27	Shoqeria"ALULIN".shpk.			2066	83/16	4000T,3				52	2650	137800		137800	konf.zvrpp
28	Shoqeria "EVEREST".shpk.			2066	83/33	2000	111	626	69486					69486	konf.zvrpp
29	Shoqeria "EVEREST".shpk.			2066	83/4	9800	40	626	25040					25040	konf.zvrpp



30	Bashkp.familija Beliu	2066	84	7300 Tr.					61	2650	161650	161650	konf.zvrpp
31	Jorgo	2066	90/64	1470	19	626		11894				11894	konf.zvrpp
32	Arben,Valbona	2066	90/86	250	11	626		6886				6886	konf.zvrpp
33	Qemal	2066	90/65	903	22	626		13772				13772	konf.zvrpp
34	Pellumb	2066	90/66	1957	10	626		6260				6260	konf.zvrpp
35	Besim	2066	90/67	800	60	626		37560				37560	konf.zvrpp
36	Besnik	2066	4/32	2100	41	626		25666				25666	konf.zvrpp
37	Hasan	2066	4/31	1475	23	626		14398				14398	konf.zvrpp
38	Hasan	2066	4/19	1000	SS	626		34430				34430	konf.zvrpp
39	Ferit	2066	4/15	1640	164	626		102664				102664	konf.zvrpp
40	Avdyl	2066	109/2	1500					205	2650	543250	543250	konf.zvrpp
	Hasan		2										
	Shuma:				1686			1055436	1749		4634850	6395523	12085809

**KËRKESË****Nr. 7536/1, datë 12.12.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rehabilitimi i zonave pranë rrethrrrotullimeve dhe kryqëzimeve, segmenti Rrogozhinë-Fier”. Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit “objekte”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 627 743 272 (gjashtëqind e njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUTURËS
Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QE SHPRONËSOHEN NGA REHABILITIMI I RRETHROTULLIMEVE RROGOZHINE FIER

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. Pas	Lloji i Pas	Sip. Ndërtese	Sip trualli	Sip trualli poshtë ndërtësës	Vlera e ndërtimit	Vlera e truallit	Vlera e truallit jashtë ndërtësës	Vlera totale	Shënim e
Rrethrotullimi i Rrogozhinës														
1	Rrahman		Balliu	3235	490/65	pike servisi dhe banese 3 kateshe	323	917	323	30,726,021	108,528	308,112	31,142,661	Rikonf.
2	Arif dhe Ramazan		Daja		259/50	Magazine 2 kateshe	860	4790	860	24,542,680	288,960	1,609,440	26,441,080	Rikonf.
3	Llazar		Angjeli		259/21	Karabina 3 kateshe	870	2730	870	37,242,090	292,320	917,280	38,451,690	Rikonf.
4	Llazar		Angjeli		259/37	objekt sherbimi 1 katesh	270	1830	270	2,536,720	26,880	678,720	3,242,320	Rikonf.
5	Hiqmet		Deda		490/60		0	3300	0	0		1,108,800	1,108,800	Rikonf.
Rrethrotullimi Cermes														
6	Ymer		Kokja	1381	237/54	biznes dhe banim 2 katesh	236.8	97	236.8	7,162,252	75,196	112,400	7,349,848	Rikonf.
7	Ymer		Kokja		237/25	shtepi banimi 1 kateshe	103	97	103	31,115,338	57,886	54,514	31,227,738	Rikonf.
8	Kujtim		Sako		307/3	biznes 1 katesh	81	75	81	2,238,204	45,522	42,150	2,325,876	Rikonf.
9	Haki		Xhepa	3590	60/15	karabina dhe banese	240	6	120	5,262,804	64,080	3,372	5,330,256	Rikonf.
10	Sali		Xhepa	1391	237/43	biznes 2 katesh	110	330	110	3,327,060	61,820	185,460	3,574,340	Rikonf.
11	Shkelqim		Kokja		44/1	biznes 2 katesh	255	545	255	7,712,730	143,310	306,290	8,162,330	Rikonf.
12	Hasan		Kokja		44/2	biznes 1 katesh	125	215	125	3,780,750	70,250	120,830	3,971,830	Rikonf.
13	Rustem		Kokja		44/3	biznes 2 katesh	656		328	19,841,376	187,616	0	20,028,992	Rikonf.
14	Nazmi		Muca	3916	503	karabina 4 kateshe	380		80	5,172,066	45,760	0	5,217,826	Rikonf.
Rrëthrotullimi i Grabianit														
15	Avni		Lila	1582	31/24	magazine ekspozite 2 kateshe	684	678	684	31,395,348	711,540	1,137,660	33,244,548	Rikonf.
16	Neim		Lila	1582	31/26	magazine ekspozite 2 kateshe	406	697	203	12,279,876	408,030	974,850	13,662,756	Rikonf.
17	Bashkepronaret Xhepexhiu			1582	31/12	objekt sherbimi 2 kateshe	710	2800	355	20,383,804	713,550	406,020	21,503,374	Rikonf.
18	Bashkepronaret Xhepexhiu			1582	31/12	objekt sherbimi dhe banimi	229		916	27,705,336	460,290	2,803,950	30,969,576	Rikonf.
19	Kujtim		Kaja	1582	31/23	objekt sherbimi dhe banimi 4 katesh	630	880	630	19,054,980	422,100	832,140	20,309,220	Rikonf.
20	Edlir		Zeka	1582		objekt sherbimi 2 kateshe	400	1300	400	24,196,800	804,000	2,211,000	27,211,800	Rikonf.
Rrethrotullimi i Plugut														
21	Bashkim		Collaku	8571	168/5	bar mini market 3 katesh				21,172,200	1,353,060	2,255,100	24,780,360	Rikonf.
22	Lili		Bushi	8571	168/8	objekt sherbimi dhe banimi				4,778,868	593,843	1,584,821	6,957,532	Rikonf.
23	Kristo		Dapi	8571	166/16	objekt sherbimi 5 katesh (karabina 3 kate)				8,166,420	372,000	1,209,000	9,747,420	Rikonf.
Rrethrotullimi I Kolonjes														
24	Marsela		Kaja	2207	262/15	objekt sherbimi 3 katesh	1207	3400	605	46,469,500	302,957	1,705,043	48,477,500	Rikonf.
Rrethrotullimi Saver														
25	Agur		Cela	2207	653/7	ndertese sherbimi dhe karburant	559		559	28,365,212	1,371,670	0	29,736,882	Rikonf.
26	Ferdinant		Saraci	2207	653/28	objekt sherbimi 2 katesh	148		148	9,261,325	315,240	0	9,576,565	Rikonf.
27	Arben		Sulo	2207	652/64/63	bar restorant hotel	391		391	35,478,558	832,830	0	36,311,388	Rikonf.
28	Novruz		Uku	2207	52/60	magazine	454		454	16,544,562	1,165,110	0	17,709,672	Rikonf.
29	Faslli		Saraci	2207	653/2	pike servisi dhe banese 2 kate	241		120	22,261,056	513,330	0	22,774,386	Rikonf.
30	Muharrem		Saraci	2207	653/3	pike servisi 2 kate	264		132	23,954,832	562,320	0	24,517,152	Rikonf.
31	Bashkim		Saraci	2207		servis			115.5	13,247,748	492,030	0	13,739,778	Rikonf.
32	Avdyl		Nurce	2207		servis				13,628,847	959,778	0	14,588,625	Rikonf.



33	Gazmir		Saraci	2207		servis				7,863,960	553,800	0	8,417,760	Rikonf.
34	Besnik		Cuko	2207	652/51	objekt sherbimi dhe banimi	286		138	15,715,821	609,180	0	16,325,001	Rikonf.
	Pushimi I Shoferit												0	
35	Artur		Mehilli	2286	8615	objekt sherbimi 1 kat	100	300	100	3,850,000	55,100	165,300	4,070,400	Rikonf.
36	Besim		Cela	2286	100/21	objekt sherbimi 1 kat	154		154	5,929,000	84,584		6,013,584	Rikonf.
37	Festim		Cela	2286	100/18	objekt sherbimi 1 kat	37		37	1,424,500	20,387		1,444,887	Rikonf.
38	Kujtim		Cela	2286	100/31	objekt sherbimi 1 kat	25	125	25	962,500	13,775		976,275	Rikonf.
39	Judmir		Cela	2286	100/27	objekt sherbimi 1 kat	166	234	166	6,391,000	91,466	128,934	6,611,400	Rikonf.
40	I paidentifikuar			2286		Karburant				6,611,400			6,611,400	Rikonf.
41	I paidentifikuar			2286		objekt banimi 2 katesh	214		214	16,478,000	117,914		16,595,914	Rikonf.
42	I paidentifikuar			2286		objekt sherbimi 1 kat	28		28	1,078,000	15,428		1,093,428	Rikonf.
	Rrethrotullimet në Fier 1, 2, 3												0	
43	Idriz		Berisha	8531	7/16-n4	magazine	18.9			586,970	0	0	586,970	Rikonf.
44	Besnik		Hoxha	8531	7/19	objekt sherbimi	54.25			1,684,842	647,040		2,331,882	Rikonf.
45	Tomor dhe Ilirian		Braho	8531	7/287	servis	18.9			586,970	225,420	0	812,390	Rikonf.
46	Estref		Agalliu	8531	7/15	lokal 3 katesh	52.9		52.9	4,928,745	655,985	0	5,584,730	Rikonf.
47	Tomor dhe Ilirian		Braho	8531	7/18	servis	35.4			1,099,418	0	0	1,099,418	Rikonf.
48	Hill		Prifti	8531	8/162	objekt sherbimi	18		18	559,026	214,686		773,712	Rikonf.
VLERA TOTALE													672,743,272	

**VENDIM***(i shkurtur)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1406, datë 30.9.2014, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Irfan Beqirllari, i

biri i Zenunit dhe Nadies, i datëlindjes 29.5.1949 dhe caktimin e kërkueses Albana Hysolli (Beqirllari) si person që do të administrojë pasurinë e tij.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 40 lekë